



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF**  
**KOSOVO**

**Komuna e Kaçanikut**  
**Opština Kačanik/Municipality of Kačanik**  
**Zyra e Kryetarit**



**05-400/03-12323**

**Kaçanik, 17.06.2026**

Procesverbal nga Konsultimi buxhetor për Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale (KABK) 2027–2029 me përfaqësues të sektorit të arsimit.

**Vendi:** Gjimnazi “Skenderbeu” - Kaçanik

**Ora:** 10:00

**Data:** 05.06.2026

Komuna e Kaçanikut, përmes Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorisë së Arsimit, ka mbajtur konsultimin publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale (KABK) 2027–2029 me përfaqësues të sektorit të arsimit.

Takimin e hapi Drejtori për Buxhet dhe Financa, Valdrin Dogani, i cili theksoi se organizimi i këtij konsultimi ka për qëllim rritjen e transparencës dhe përfshirjen e palëve të interesit në procesin e planifikimit buxhetor. Ai bëri të ditur se buxheti i planifikuar për sektorin e arsimit për vitin 2027 është 4,492,490 euro, shumë e bazuar në numrin e nxënësve, nga e cila një pjesë dedikohet për paga dhe mëditje, ndërsa pjesa tjetër për investime kapitale në arsim.

Nga ana tjetër, Drejtori i Arsimit, Gazmend Bunjaku, tha se investimet kapitale do të fokusohen në përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe sportive, digjitalizimin e shkollave, renovimin e nyjeve sanitare, si dhe rregullimin e hapësirave të jashtme të objekteve shkollore.

Drejtori Bunjaku foli edhe për sfidat me të cilat përballlet sektori i arsimit në Komunën e Kaçanikut, duke theksuar mungesën e mbështetjes nga niveli qendror. Sipas tij, kërkesat e komunës janë adresuar vazhdimisht në ministritë përkatëse, por shpeshherë kanë mbetur pa përgjigje. Ai përmendi gjithashtu barrën financiare që u është transferuar komunave nga obligimet që rrjedhin nga kontratat kolektive.

Po ashtu, ai vlerësoi se fondi i ndarë për arsim, i bazuar në numrin e nxënësve, është i pamjaftueshëm për të përmbushur nevojat reale të sektorit. Megjithatë, Komuna e Kaçanikut ka vazhduar të investojë në arsim përtej kufizimeve buxhetore, me qëllim të krijimit të kushteve sa më të mira për nxënësit, duke mbështetur edhe bursat dhe transportin e nxënësve.

Të pranishmit në debat, përfaqësues të institucioneve arsimore, patën mundësinë të paraqesin propozimet, vërejtjet dhe rekomandimet e tyre lidhur me prioritetet buxhetore për periudhën e ardhshme.

**Fetije Axhami Kuka- drejtoreshë në QEAP “ Agimi”**

Kërkoj që me investimet e planifikuara të përfshihet edhe rregullimi i terassës, të shikohet instalimi i ujit të brendshëm sepse ka krisje të mureve, si dhe rregullimi i trafave të rrymës për të forcuar energjinë elektrike. Poashtu si do të bëhet forma e dezinfektimit në institucionet shkollore.

**Zekirja Baftiu Drejtor i ShMP “ Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”**

A është i përfshirë aneksi, kemi probleme me material hargjues, në kontratën e mirëmbajtjes nuk janë të përfshira të gjitha materialet që na nevojiten.

**Xhevdet Hysa- Drejtor i Shkollës Filllore “ Agim Bajrami”**

Jemi të kënaqur me investimet komunale, kërkojmë digjitalizim pra kompjuterë të rinjë për kabinetin e i informatikës, sepse kemi kompjuterë të vjetër.

**Xhemil Hajdari- “Shkolla Filllore “Kadri Zeka”- Dubravë**

Kërkohet ndërtim i toaleteve në katin e dytë si dhe ndërtimi i një daljeje emergjente.

**Bajram Troni- Shkolla Filllore “ Tre dëshmorët” Kovaqec**

Të bëhet pjesa e drenazhës, të rregullohen kabinetet e informatikës, ngjyrosja e rrethojave.

**Nuredin Dullovi- Drejtor i Shkollës Filllore “ Jusuf Gërvalla”**

Të bëhet rregullimi i rrugës të hyrja e shkollës që lidh shkollën dhe ambulantën e fshatit, një rrugë e ngushtë, të bëhet zgjerimi i rrugës si dhe trotuari, si dhe të bëhet ngjyrosja e rrethojave në Nikaj dhe Biqec.

**Ilaz Krasniqi- Shkolla Filllore “Qamil Ilazi”**

Kërkoj që të bëhet rregullimi i fushës sportive , riparimi i sistemit të ngrohjes, pajisja me tabela digjitale, ndriçimi jashtëm i oborrit të shkollës, vendosja e kamerave, renovimi i nyjeve sanitare, rregullimi i kabinetit të informatikës si dhe rregullimi i toaleteve në paralelen e ndarë në katin e dytë.

Për të gjitha kërkesat u diskutuan dhe u dhanë përgjigje edhe nga drejtori i Arsimit dhe stafi përcjellës, ndërsa në vazhdim do të përgatitet edhe raporti me detaje për secilën kërkesë të parashtruar.

Procesmbajtëse

Fatlume Guri Selimi  
Zyrtare e Lartë për Komunikim

